

PREZENCA SOCIALE E PËRCEPTUAR GJATË EDUKIMIT VIRTUAL TEK
STUDENËT KOSOVAR

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË FUSHËN

PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

Nga

Vlora Sekiraqa



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

PSIKOLOGJI

PRISHTINË

Korrik, 2022

PREZENCA SOCIALE E PËRCEPTUAR GJATË EDUKIMIT VIRTUAL TEK STUDENËT KOSOVAR

Kandidatja: Vlora Sekiraqa

Mentore: Prof. Ass. Kaltrina Kelmendi

Qëllimi i këtij punimi master ka qenë të verifikojë mbi prezencën e ndryshores së prezencës sociale dhe shkallës së kënaqësisë të perceptuar nga studentët kosovar përgjatë ndjekjes së ligjëratave në platformën online. Studimi thekson rëndësinë e raporteve sociale dhe marrëdhënieve me të tjerët në fushën e edukimit dhe rritjes akademike. Njëkohësisht vë theksin te sfidat në të cilat ka kaluar sistemi edukativ për ofrimin e platformës online marrë parasysh kontekstin në të cilin ka qenë paraprakisht. Duke qenë që është hera e parë që sistemi edukativ arsimor i lartë në Kosovë ofron ligjërata online është parë e rëndësishme të analizohet shkalla e prezencës sociale në këtë platformë dhe shkalla e kënaqësisë. Këto dy ndryshore janë shumë të rëndësishme në mbarëvajtjen e suksesshme dhe kualitetin e mësimëve, sidomos në platformën virtuale ku prezenca sociale është më vështirë e arritshme. Punimi sipas strukturës ndahet në gjashtë kapituj.

Kapitulli I përmban hyrjen ku theksohet rëndësia e studimit dhe analiza e ndryshoreve të prezencës sociale dhe shkallës së kënaqësisë në kushtet e edukimit virtual. Njëkohësisht ky kapitull ofron informacion mbi ndryshoren e edukimit online si ndryshore e jashtme kontekstuale e cila ka determinuar edhe synimin tonë për të analizuar mbi ndryshoret e testuara. Konteksti teorik dhe prezenca sociale janë pjesë të kapitullit të parë të cilat orientojnë punën dhe qëllimin e studimit aktual.

Kapitulli II paraqet shqyrtimin e literaturës i cili është i fokusuar mbi perceptimin e prezencës sociale përgjatë edukimit online. Studimet e shqyrtuara raportojnë për shkallë jo të lartë të kësaj ndryshore në mbarëvajtjen e mësimin në platformën online krahasim me klasat. Përgjatë shqyrtimit të artikujve është shtuar edhe ndryshorja e shkallës së kënaqësisë e cila gjithashtu po sikurse prezenca sociale na pasqyron informacion mbi mbarëvajtjen e mësimin online në raport me plotësimin e nevojave sociale në platformën e mësimin online dhe kënaqësisë së përgjithshme me orët e mbajtura online.

Kapitulli III paraqet metodologjinë e studimit. Shtjellon qëllimin dhe objektivat e studimit gjithashtu pyetjet kërkimore të cilat kanë orientuar punën dhe hipotezat e ngritura për krahasim. Qëllimi i studimit aktual është të kuptohet më shumë rreth mbarëvajtjes së mësimin

online gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 e cila shkaktoi mbylljen fizike të institucioneve arsimore. Duke marrë parasysh që literatura e shqyrtuar vetëm se ka ngritur theksin të rëndësia e prezencës sociale në një ambient të mësimit virtual objektivat e studimit në fjalë do të kenë fokus:

1. Të verifikohet nëse prezenca sociale ka qenë prezent gjatë mbarëvajtjes së mësimit online sipas perceptimit të studentëve kosovar.
2. Të verifikohet rreth shkallës së kënaqësisë të perceptuar nga studentët në raport me mësimin online.
3. Të shikohet nëse ka dallime gjinore mes studentëve në raportin mes prezencës sociale dhe kënaqësisë në mësim.
4. Të shikohet për dallimet në mes të studentëve që kanë pohuar që kanë mbajtur mësimin në ambient komod dhe të rehatshëm, pa problem me internetin në krahasim me studentët që kanë pohuar që ambienti i tyre nuk ka qenë komod dhe që kanë raportuar problem për tu qasur në internet.

Studimi në fjalë është i llojit ndërseksional eksplorues pasi që tenton të verifikojë prezencën e një ndryshore si është prezenca sociale gjatë edukimit virtual si ndryshore e shkaktuar nga rrethanat e jashtme. Të drejt pjesëmarrje në studim kanë pas të gjithë të rinjtë kosovar të cilët ndjekin studimet në territorin e Kosovës dhe që kanë ndjekur të paktën një semestër në platformën online, dhe gjithsej kemi pasur 126 të respondent. Mënyra e mbledhjes së të dhënave ka qenë me sondazh online. Për të matur ndryshoren e prezencës sociale është përdorë instrumenti i zhvilluar nga Guan-Yu Lin (2004) Social Presence Questionnaire of Online Collaborative Learning. Për kënaqësinë në mësim, është përdorë pyetësi i cili matë shkallën e kënaqësisë në një orë mësimi online i zhvilluar nga (Gunaëardena & Zittle, 1997). Pyetjet e edukimit online janë pohime në të cilat studenti përgjigjet me e vërtetë ose jo e vërtetë, pyetjet janë krijuar për qëllim të këtij studimi. Për ndryshoren e prezencës sociale dhe shkallës së kënaqësisë dhe për të raportuar shtrirjen e tyre në mostrën e studimit janë analizuar mesataret për secilën ndryshore, dhe për krahasim të hipotezave është përdorë Independent Sample t test për prezencën sociale dhe Mann-Ëhitney u test për shkallën e kënaqësisë.

Kapitulli IV prezanton rezultatet e fituara pas analizës së të dhënave. Sipas rezultateve studentët kanë raportuar mesatare të ulët të prezencës sociale dhe nën shkallëve të saj: Perceptimi i ndihmës në grup për të mësuar ($m=2.92$), komoditeti social i të shprehurit

($m=2.82$), navigacionit social($m=3.12$) dhe shkallë të ulët të perceptimit të kënaqësisë ($m=3.23$). Gjithashtu janë paraqitur statistikat krahasuese për dallimet gjinore në raport me këto dy shkallë, dallimet ndërmjet grupit të studenteve që kanë raportuar problem me internet dhe studentëve që kanë raportuar ambient të rehatshëm dhe të qetë për ndjekjen e ligjëratave online. Siç është pritur nuk janë gjetur dallime gjinore. Gjithashtu i vetmi faktor që ka afektuar perceptimin e prezencës sociale ishte vendi i duhur për të studiuar.

Kapitulli V diskuton të gjeturat e punimit në fjale në raport me studimet e tjera. Studentët tanë kanë raportuar shkallë të ulët të prezencës sociale dhe mesatarë të ulët të shkallës së kënaqësisë në platformën online dhe këto të gjetura përputhën me studimet paraprake të cilat konfirmojnë që prezenca sociale është më e ulët në orët online në krahasim me orët në klasa. Ky kapitull gjithashtu i komenton te gjeturat nën dritën e eksperiencës aktuale dhe në raport me resurset e përdorura nga stafi akademik dhe të gjitha palëve të përfshira.

Kapitulli VI është i ndërtuar mbi një përmbledhje e të gjeturave kyçe të studimit dhe ngrit rendësin e fillimit të studimeve të ardhshme me fokus mbi edukimin online dhe prezencën sociale. Duke ritheksuar rendësin e studimit aktual i cili na ofron një pasqyrë të mbarëvajtjes së edukimit online nën këndvështrimin të prezencës sociale të perceptuar nga studentët. Gjithashtu rekomandohen studime të cilat do ndihmonin në krijimin e kushteve më të mira për të shtuar prezencën sociale gjatë edukimit online, dhe rekomandohet studime për të kuptuar përfitimet nga integrimi i sistemit online ose të kombinuar në sistemin tonë akademik.